



Informacion

Taksimetra – Çka duhet të dini



Sa i saktë duhet të jetë një taksimetrë?

Gjatë matjes së rrugës së vozitur, në bazë të Rregullores për taksimetra, lejohet që një taksimetrë të matë jo më tepër se dy përqind më shumë apo më pak. Gjatë një vozitjeje prej dhjetë kilometrash lejohet që matja të devijojë maksimalisht dyqind metra nga vlera e vërtetë.

Kush është përgjegjës për saktësinë e një taksimetrit?

Pronarët e pronarët e taksive vetë janë përgjegjës, që taksimetra në taksitë e tyre në çdo kohë të punojnë brenda kufijve të lejuara të gabimeve.

Si mund ta kontrolloj unë vetë saktësinë?

Taksimetra modernë kanë një lloj modusi, që tregon rrugën tashmë të kaluar. Në një rrugë të matur saktësisht shumë lehtë mund të shihet dallimi (shiko faqen e prapme).

Kur duhet ta kontrolloj saktësinë e taksimetrit tim?

Kontrolli duhet bërë së paku **një herë në vit** si dhe **pas çdo ndryshimi tek automjeti**, i cili mund të ndikojë në matjen e rrugës. Ndikim në matjen e rrugës kanë për shembull ndryshimet te rrotat apo ndërhyrjet në sistemin elektronik të automjetit. Kontrollimet e bëra duhet të protokollohen. Protokollin duhet të mbahet me vete në automjet.

A mund t'ia dorëzoj dikujt këto kontrollime?

Po. Çdo garazh i specializuar është në gjendje të bëjë kontrollime të tilla. Mirëpo përgjegjësia mbetet gjithnjë te pronari i taksisë.

Çka duhet të marrë parasysh nëse blej një taksimetrë të ri?

Taksimetra e rinj duhet t'i plotësojnë kushtet e rregullores për taksimetra. Është detyrë e prodhuesit të vërtetojë, se një mjet i tillë i plotëson këto kërkesa. Për secilin taksimetrë, prodhuesi duhet të lëshojë një deklaratë konformiteti me shkrim. (Gjendja e mbetur e taksimetrave jo-konformë mund të shitet ende deri në fund të vitit 2015).

Edhe për sa kohë mund ta përdor taksimetra tim të sotëm?

Taksimetra, të cilët janë në gjendje t'i plotësojnë kushtet e saktësisë, mund të përdoren më tej deri më 31 dhjetor 2025, edhe në rastin që nuk e kanë deklaratën e konfirmimit të prodhuesit. Taksimetra që nuk i plotësojnë kushtet e saktësisë, duhet të ndërrohen me patjetër deri në fund të vitit 2015.



Pronaret/pronarët e taksive vetë janë përgjegjës, që taksimetra në taksitë e tyre në çdo kohë të punojnë brenda kufijve të lejuara të gabimeve.

Procedura e ruajtjes së qëndrueshmërisë së matjes për taksimetra (Shtojca 2 e Rregullores për taksimetra)

- 1 Kontrolli mund të bëhet nga përdoruesi vetë apo në porosi të tij nga një person kompetent në këtë fushë.
 - 2.1 Gjatë testimit, në bazë të një distance të njohur më së paku 1000 metra gjatësi, duhet krahasuar rruga e kaluar faktike me rrugën e matur dhe të treguar nga taksimetri. Rezultati duhet të protokollohet.
 - 2.2 Personat profesionalë kompetentë, të cilët disponojnë me një pajisje speciale për përlllogaritjen e numrit të impulsave të taksimetrave, do të duhet që me këtë pajisje të kryejnë në një rrugë një kontroll, i cili është më i shkurtër sesa është i paraparë në shifrën 2.1. (...).
- 3 Në protokoll duhet të shënohen së paku këto të dhëna:
 - të dhënat mbi përdoruesin;
 - identifikimi i qartë i automjetit;
 - data e kontrollit;
 - gjatësia e rrugës që testohet;
 - rruga e treguar nga taksimetri;
 - rregullimet eventuale që janë kryer në taksimetër, posaçërisht ndërrimi i numrit të impulsave;
 - emri i personit, i cili e ka kryer kontrollin.
- 4 Protokollin duhet të mbahet në automjet.

Protokolli për kontrollin e taksimetrit

Protokolli kontrollues i obligueshëm i testimit, i cili duhet të mbahet në automjet, mund të merret nga METAS-i në një fletë-paloseje praktike tre-pjesësh në formatin e një leje qarkullimi.

Ky protokoll i përmban në mënyrë të përmbledhur informacionet dhe udhëzimet më të rëndësishme dhe ofrohet në gjermanisht, frëngjisht dhe italisht.

Në faqen www.metas.ch/taxi si alternativë për shkarkim dhe printim e keni tashmë në dispozicion modelin në formatin A4.

Instituti Federal (Zvicëran) për Metrologji METAS

Lindenweg 50, CH-3003 Bern-Wabern, Telefon +41 58 387 01 11, www.metas.ch

Rrugët për kontrollim

Rrjeti i rrugëve për testim të taksimetrave në bazë të shtojcës 2 të Rregullores për taksimetra, është duke u ndërtuar. Rrugët në dispozicion të matura saktësisht janë të dokumentuara në internet.

Ky rrjet po zgjerohet vazhdimisht.

Në faqen www.metas.ch/taxi gjenden po ashtu:

- teksti origjinal i Rregullores për taksimetra
- pyetje e përgjigje (FAQ) të shpeshta në lidhje me Rregulloren për taksimetra
- ky trakt (fletushkë) si PDF-skedar



Dokumentacioni i një rruge që duhet të kontrollohet (model)

Kontrollimet që bëhen nga METAS-i

Instituti Federal (Zvicëran) për Metrologji METAS është organi mbikëqyrës përgjegjës për taksimetra. Ky institut kontrollon zbatimin e rregullave.

Kontakti

Mail: taxi@metas.ch
Telefoni: 058 387 01 11

Interneti

www.metas.ch/taxi